

VAKSINIMI COVID-19

Informacion për të rriturit me sëmundje kronike dhe personat e moshës 65 vjeç e lart

A keni ndonjë sëmundje kronike?

A jeni 65 vjeç ose më i madh?

Covid-19 është i rrezikshëm për ju.

Prandaj rekomandojmë: Të vaksinoheni.

Pse është i rrezikshëm Covid-19 për ju?

Covid-19 mund të ketë pasoja të rënda dhe madje shumë të rënda për ju. Për shembull gulçim në rastin e pneumonisë. Pastaj ju duhet oksigjen dhe duhet të shkoni në spital. Mund t'ju duhet shumë kohë për tu rikuperuar. Nëse përkeqësoheni nga Covid-19, ju duhet të trajtoheni në Njësinë e Kujdesit Intensiv. Ju mund të keni nevojë për frymëmarrje artificiale. Covid-19 mund të dëmtojë edhe organet e tjera dhe ju mund të vdisni nga kjo.

Për cilat sëmundje kronike rekomandojmë vaksinimin nga Covid-19?

Ne rekomandojmë vaksinim në rast të:

- Tensionit të lartë të gjakut
- Sëmundjeve kardiovaskulare
- Diabeti
- Sëmundjet kronike të frymëmarrjes
- Kanceri
- Sëmundje dhe terapi që dobësojnë sistemin imunitar
- Shumë mbipeshë

Nëse jeni një nga njerëzit me rrezikshmëri më të lartë me sëmundje kronike: Mjeku që ju trajton do të rekomandojë urgjentisht vaksinimin tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.

Është vaksinimi efikas dhe i sigurt?

Çdo vaksinë ka nevojë për miratim dhe rekomandim në Zvicër. Për ta bërë këtë, ajo duhet të plotësojë standarde të larta për sigurinë, efikasitetin dhe cilësinë. Agjencia Zvicerane për Produkte Terapeutike, Swissmedic, ka ekzaminuar dhe miratuar me kujdes vaksinën kundër Covid-19. Ajo është e sigurt dhe efikase. Dhjetëra mijëra njerëz tashmë kanë marrë vaksinën gjatë punës kërkimore. Është gjithashtu e sigurt dhe efikase tek të moshuarit edhe me sëmundje kronike. Studimet tregojnë se deri më tani (nga mesi i dhjetorit 2020) nuk ka efekte anësore të rënda.

Swissmedic vazhdon të monitorojë sigurinë dhe efikasitetin e vaksinës.

Në përgjithësi: Rreziku i efekteve anësore serioze pas vaksinimit është shumë më i vogël se rreziku i përparimit serioz të sëmundjes pas infektimit nga koronavirusi.

Kush nuk duhet të vaksinohet?

Ne nuk u rekomandojmë vaksinimin Covid-19 këtyre njerëzve:

- Njerëzve me alergji të rëndë të konfirmuar ndaj cilitdo përbërës të vaksinës (veçanërisht PEG).
- Grave shtatzëna. Deri më tani nuk ka të dhëna për vaksinimin gjatë shtatzënisë.
- Fëmijëve dhe adoleshentëve nën 16 vjeç. Deri më tani nuk ka të dhëna për vaksinimin në këtë grupmoshë.

Ku mund të gjeni më shumë informacion?

Informacione të mëtejshme mbi vaksinimin nga Covid-19 mund të gjenden në faqen e internetit të BAG: www.foph-coronavirus.ch/vaccination (anglisht)

Ose pyesni mjekun tuaj. Ose në farmacinë tuaj.

www.foph-coronavirus.ch/vaccination

Linja telefonike e vaksinimit ndaj Covid-19: 058 377 88 92



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Bundesamt für Gesundheit BAG
Office fédéral de la santé publique OFSP
Ufficio federale della sanità pubblica UFSP
Uffizi federal da sanadad publica UFSP

Albanisch / albanais /
albanese / shqip



Më shumë
informacion